




PROVINCIA AUTONOMA DI TRENTO

Servizio per lo sviluppo e l'innovazione  
del sistema scolastico e formativo  
Ufficio di coordinamento pedagogico generale

# Mirësevini

## *Benvenuti in lingua albanese*



F.I.O.R.E.

FAMIGLIA, INFANZIA,  
ORIENTAMENTI,  
RIFLESSIONI EDUCATIVE



PROVINCIA AUTONOMA DI TRENTO  
Servizio per lo sviluppo e l'innovazione  
del sistema scolastico e formativo

# Mirësevini

*Benvenuti* in lingua albanese

© Provincia autonoma di Trento - 2009  
Servizio per lo sviluppo e l'innovazione del sistema scolastico e formativo

*A cura dell'Ufficio di coordinamento pedagogico generale*  
Miriam Pintarelli, Anna Tava

*Collaborazione Ufficio Stampa*  
*Coordinamento editoriale* Silvia Vernaccini

*Referenze fotografiche* Scuole dell'infanzia provinciali:  
Calavino - Palù di Giovo - Roveré della Luna  
S. Michele a/Adige-Faedo - Terlago -  
Trento-Madonna Bianca - Trento-S. Giuseppe  
Trento-Solteri - Verla di Giovo

*Progetto grafico ed impaginazione* Palma & Associati  
*Stampa* Litotipografi a Alcione

BENVENUTI

/ a [cura dell'Ufficio di  
coordinamento pedagogico generale, Miriam  
Pintarelli, Anna Tava]. - Trento : Provincia  
autonoma di Trento, 2009. - 96 p. : ill. ; 24  
cm. - (FIORE)

Nome dei cur. dal verso del front.

ISBN 978-88-7702-239-4

1. Bambini - Educazione - Scuola materna  
I Trento (Provincia). Ufficio di coordinamento  
pedagogico generale I. Pintarelli, Miriam II.  
Tava, Anna  
372.218

BENVENUTI  
VERSIONE PLURILINGUE (in lingua albanese)

Collaborazioni

*Adattamento e selezione testi*  
Grazia Modugno

*Traduzioni*  
Segreteria Generale della Provincia - I.S. per la realizzazione di grandi eventi  
Cooperativa Città Aperta - Rovereto

*Stampa* Centro Duplicazioni PAT  
Gennaio 2012

*Mirësevini* është një përshëndetje e përzemërt  
dhe një botë mikpritjeje  
që edhe në jetën e përditshme  
nënvizon kënaqësinë e një takimi,  
e një njohjeje  
të çliroje atë që përshëndesim nga çdo njësi ndrojtjeje  
dhe ti' japë kënaqësi ne marrëdhëniet e komunikimit.

*Mirësevini* është titulli  
që kemi dashur të mbajmë  
edhe për këtë edicion të ri të tekstit  
sepse është një mesazh që hap dyert e komunikimit,  
dhe në këtë rast ka të bëjë me prindërit  
e vajzave dhe djemve  
që po hyjnë për herë të parë  
në kopshtin e fëmijëve  
për të ndërmarrë rrugën e dijes  
dhe të bashkëpunimit.



## **Përmbledhje**

<b>Prezantimi</b>	<b>6</b>
<b>Fillojmë të prezantohemi</b>	<b>9</b>
<i>Një fazë e rëndësishme e rritjes të hysh e të bësh pjesë në një mjedis të ri</i>	<b>13</b>
<i>Ku dita rrjedh ndryshe nga ajo në shtëpisë me momente të ndryshme dhe të njohura</i>	<b>17</b>
<i>Bëhesh anëtar i një organizate të madhe në të cilën komunikohet dhe bashkëpunohet</i>	<b>21</b>
<i>Në një kohë që merr kuptim e shoqëruar nga siguria e rutinës</i>	<b>25</b>
<i>Ku fëmijët të mësojnë nëpërmjet lojës duke u zbatimur dhe seriozisht</i>	<b>29</b>
<i>Në kuadër të një projekti edukativ të kombinuar me argëtim e dijeni</i>	<b>33</b>
<i>I drejtuar nga persona kompetent dhe ndjesihollë profesionistë dhe të kujdesshëm</i>	<b>37</b>
<i>Që njohin momentet më të "brishta" vetperceptimit i madh apo i vogël</i>	<b>41</b>
<i>Si të qëndrohet në shkollë edhe më gjatë në atë kohë të zgjatur që kthehet në speciale</i>	<b>45</b>
<i>E gjithë kjo, dhe shumë më tepër, brenda organizimit të madh të shkollës Provinciale Trentine</i>	<b>49</b>
<i>Shënime mbi kopshtin e fëmijëve të djalit /vajzës time</i>	<b>63</b>
<b>Hapësirë për shënime personale</b>	<b>65</b>

## Prezantimi

### **E para "Mirësevini" lindi në vitin 2002**

Në vitin 2002 lindi ideja e parë për të vënë në dispozicion një broshurë të koncentruar mbi eksperiencën e hyrjes për herë të parë të fëmijëve në kopsht, si ajo e fillimit të vitit shkollor, ku e gjithë shkolla ( ashtu edhe kopshti) vihen në lëvizje, ashtu edhe gjatë vitit shkollor ku fëmijët gjejnë një ambient karakteristik. Situata të ndryshme, por që gjithmonë kanë nevojë për kujdes dhe ndjekje graduale. Objektivi që donim të realizonim me gjithë zemër ishte që t'u bënim të njohur prindërve këtë botë para se të merrnin pjesë realisht në të; pak për të përgatitur terrenin dhe pak për të lehtësuar këtë fazë të re, e cila në disa raste përfaqëson daljen për herë të parë të fëmijëve nga familjet e tyre, ndërsa për të tjerët është kalimi nga çerdhja në një mjedis tjetër. Që atëherë, *Mirësevini* ka kaluar në duart e shumë prindërve, është shpalosur, lexuar dhe diskutuar së bashku me mësuesit.

### **dhe sot ndërron pamjen**

Sot, *Mirësevini* arrin botimin e tij të tretë, dhe ka hyrë në botimet e F.I.O.R.E. që ka lindur ndërkohë me qëllim të njëjtë, të flasë për argumentet që ndikojnë në rritjen e fëmijëve. Pra *Mirësevini*, ka gjetur vendin e tij ideal, i paraprirë nga vepra të tjera që kanë trajtuar tema të rëndësishme - të tilla si të ushqyerit, autonomia, zbulimi dhe eksplorimi i hapësirës, brenda dhe jashtë kopshtit - natyrisht e ndjekur nga çështje të tjera që trajtojnë tema të ndryshme nga këto. Brenda F.I.O.R.E. nuk ekziston një rend i vendosur, çdo tekst është i veçantë dhe në të njëjtën kohë i lidhur zinxhirë me një lloj vazhdimësie me të tjerët, i përbërë nga imazhe dhe fjalë ku gjejmë fuqinë e emocioneve, të përshtypjeve dhe mendimeve.

**por duke  
ruajtur të  
njëjtën frymë**

Por fryma që i jep jetë *Mirësevini*, nuk ka ndryshuar: të japë një mesazh mirëpritjeje. Në fakt, nuk është as e perceptueshme ideja e mbarimit të pafundësisë së këtyre mundësive, ajo ka dëshirë të stimulojë lindjen e të tjera pyetjeve tek prindërit që nga momenti e parë i takimit me kopshtin, pyetje të cilat zakonisht i bëjnë vetëm pas disa kohësh. *Mirësevini*, pra flet për kopshtin, si është ai, si mendon, si është i organizuar, pa hyrë në detaje të organizimit të ndërtuar dhe përshtatur për raste të veçanta. Konkretisht dhe me shembuj të përditshme jep një imazh dhe u përgjigjet pyetjeve më të shpeshta të bëra nga prindërit.





**shpjegon  
kombinimin e  
jetës së  
përditshme me  
atë të sistemit  
parashkollor**

Shpjegimi fillon duke u përpjekur të inkuadrojë se në çfarë tipi hyn eksperiencia e ardhjes në kopsht dhe çfarë dimensionesh vë në provë. Gjithashtu shpjegon situata dhe sjellje duke hyrë në brendësi të proceseve të pashmangshme që ndodhin në këtë fazë. Fokusi pastaj shkon në përshkrimin e një ditë të zakonshme, me ritualet që e bëjnë të normale, me një organizim që mund të përballojë edhe ndonjë të papritur, me eksperiencë e qëndrime të përshtatshme, me propozime që e kualifikojnë atë nga ana cilësore, dhe mbi çdo gjë, marrëdhëniet që krijohen dhe kënaqësia e të qëndruarit së bashku. Së fundi, parashikon kuadrin e referimit, brenda të cilit kopshti i fëmijëve është inkuadruar.

*Mirësevini* vazhdon kështu të pëshkruaj momente reflektimi që duan të japin një kuptim krahasimit të hapur midis kopshtit dhe familjes. Në fund, ajo është një instrument i projektuar, përveç të tjerash, nga çdo kopsht, për të nxitur dialogun rreth çështjeve që janë të rëndësishme, fillimin e një dialogu që do të vazhdojë në çdo realitet kopshti të veçantë.



## Fillojmë të flasim...

### **Hyrja u përket fëmijët dhe të rriturit**

Eksperienca e hyrjes për herë të parë në kopshtin e fëmijëve, është diçka që u përket vetem fëmijëve? Vështirësia është vetëm e tyre? Të gjitha këto emocione, edhe të kundërta, lënë diçka adhe tek të rriturit që i shoqërojnë? Këndvështrimi jonë është jo! Nuk është vetem fëmija që fillon të përshkojë një rrugë të re, ndonjëherë me shpresë se është shenjë që ai po rritet; kemi edhe prindërit. Fëmija e eksploron dhe më në fund bëhet padron i këtij vendi duke e zbuluar dalëngadalë dhe duke e bërë të vetin, pranon të transportohet gradualisht nga klima e këndshme, nga interesi që gjen përreth, gjithashtu edhe prindi ka nevojë të kuptojë menjëherë, të ndjej dhe të mësojë. Nuk përfshihen vetëm prindërit por edhe edukatorët kanë rolin e tyre.

### **në një proces të njohjes që është baza e të ecurit së bashku**

Fillon atëherë nga larg ajo "punë" e ngadaltë e përgatitjes që të çon në këtë fazë; fillon me kontaktet e para akoma në fazën e regjistrimit, përforcohet nëpërmjet iniciativave të implementuara nga shkolla për të njohur grupin e ri që po krijohet, konkretizohet në shumë situata që në njëfarë mënyre parapërgatisin atë që do të jetë përfundimtare. Futja e fëmijëve për herë të parë në kopsht, në mëndje të edukatorëve dhe prindërve, është konceptuar gjithmonë – si një moment delikat të cilit i duhet dhënë kujdesi maksimal. Prindi ndjen nevojën të krijojë besim tek kopshti, që perceptohet edhe nga mënyra se si prezantohet, pastaj pranon t'i afrohet. Dhe Kopshti ndjen nevojën e njohjes së prindërve sepse janë pikërisht ata, bota që fëmijët sjellin me vete.

**me objektive të përbashkëta**

Mbi këto kushte të përbashkëta fillon aktiviteti: kopshti aktivizohet në drejtim të prindërve duke organizuar takimet që kanë vlerë shkëmbimi, por edhe vetë prindërit interesohen për kopshtin, kërkojnë informacionet e para, ato bazë dhe marrin pjesë në takimet e promovuara.

Objektivi qëndror për të dy palët është, që fëmijët të përjetojnë sa më normalitet e pa vështirësi hyrjen në kopsht, Përsëritja e këtij takimi çdo vit demonstroi ngadalësi në kuptimin reciprok mes kopshtit dhe familjes. Për këtë duket sikur nuk mjaftojnë asnjëherë instrumentet dhe rastet që ndihmojnë në këtë drejtim.

Sigurisht, nga një anë është koha, ajo që të çon në njohje dhe familjaritet, nëpërmjet rregullimit progresiv të raporteve sipas situatave që prezantohen, por nga ana tjetër është edhe mënyra se si fillon lidhja e kontakteve, e cila ndihmon mirëkuptimin.

**vullneti për të ndërtuar raporte domethënëse**

Gjatë këtij rrugëtimi të ngadaltë lihet pas pasiguria e natyrshme që sjell ndrojtja reciproke se mos bëjmë hapa fallso dhe u hapet rrugë natyrshëm raporteve të përditshme.

Familja dhe kopshti që më parë nuk njiheshin, tani arrijnë të krijojnë lidhje të rëndësishme, por asgjë nuk është e sigurve gjatë këtij procesi; ka vështirësi që të "zbulohen" vlera, preferime, shpresa dhe të harmonizohen mundësi të ndryshme akoma të pa zbuluar deri në fund.

Edhe në komunikim mes të rriturve duhet një "investim" në të njëjtën mënyrë sikur edhe për fëmijët. Brenda kësaj dinamike trekëndëshe zhvillohet e gjithë eksperiencia e hyrjes së fëmijëve në kopsht: ashtu si fëmija qëndron dhe bën, me të njëjtin hap edhe rriturit përjetojnë ngjarjet e thurin raportet.

**Një moment i paraqitjes para shoqërisë**

Periudha parashkollore prezanton një kthesë të rëndësishme për familjen: ndryshojnë ritmet e frekuentimit, dalin pyetje që janë të përbashkëta me të tjerët dhe rritet mundësia e bashkëndarjes së ideve dhe qëndrimeve. Fëmija dalëngadalë ndërthur raportin personal me miqtë që dëshiron t'i takojë edhe jashtë orarit të kopshtit, për shembull në parkun e lodrave, duke dërguar edhe të afërmit e tij drejt të njohurve të rinj. Universi i vogël familjar zgjerohet dhe pasurohet.







## **Një fazë e rëndësishme e rritjes pjesëmarrja si anëtar i një ambienti të ri**

### **Nga shtëpia ose nga çerdhja drejt sfidave të reja**

Periudha e fillimit gjatë së cilës fëmija ambientohet dhe njeh kopshtin, quhet *përfshirje* (hyrje). Të përfshihesh (hysh) në një situatë të re, me persona e veprime të ndryshme nga ato të shtëpisë, kërkon një proces që do pjesëmarrje graduale për anëtarësim në grup. Kjo nuk është një fazë e kufizuar vetëm në ditët e para, por është një periudhë që përjetohet nga fëmijët në mënyrë personale, njëkohësisht u kërkon të rriturve të mendojnë dhe të gjejnë mënyra dhe forma sa më të përshtatshme për secilin dhe për të gjithë së bashku. I ardhur nga shtëpia apo nga çerdhja, fëmija hyn në një grup me bashkëjetesë më komplekse, ku gjen më shumë fëmijë me të cilët ndërvepron dhe disa të rritur me të cilët do të qëndrojë. Pra vë në provë zotësitë sociale që ka grumbulluar dhe përfiton të tjera duke bërë një hap të madh në rritjen e tij psikologjike.

### **Koha e perballimit është personale**

Nëse ndonjë fëmijë shfaq me shpejtësi që ka hyrë në realitetin e ri, duke demonstruar kënaqësi në pjesëmarrje, dashamirësi për edukatorët dhe preferenca për mikun e zemrës, është normale që për ndonjë tjetri i duhet me tepër kohë. Në fakt, ka fëmijë që kanë nevojë të vërejnë gjatë para se të hyjnë në lojë me bashkëmoshatarët ose të arrijnë të kenë raporte të ngushta me personat e tjerë. Fëmijët janë të ndryshëm prandaj është e ndryshme edhe e mënyra e tyre për të përballur të reja: dikush preferon të rrijë afër të rriturve, dikush qëndron veç, dikush zhytet në lodra dhe dikush i provon të gjitha...

Duke gjetur edhe akorde me familjen, kërkohen mënyra dhe koha më e përshtatshme që fëmija të ambientohet dhe të krijojë marrëdhënie mirëbesimi. Sistemi parashkollor konsideron me kujdes nevojat e fëmijëve dhe akoma më me kujdes ato të porsardhurve, duke parapërgatitur vendin dhe aktivitete të vogla, duke menduar që çdo fëmijë ka historinë e tij familjare dhe të eksperiencës paraprake në shoqëri, të cilat, sigurisht, duhen mbajtur parasysh. Prandaj edukatorët kujdesen: të njohin shenjat dhe sinjalet e lodhjes, të kërkojnë motivet e ngurrimit, të ekspresioneve normale që tregojnë shqetësim o dekurajim, të njohin edhe momentet e forta të krizës.

### **sjelljet e fëmijëve vërehen me kujdes**

Ndonjëherë fëmijët befasojnë prindërit me sjellje të papritura, por eksperiencia e edukatorëve mund t'i ndihmojë të mëdhenjtë dhe të vegjlit për rikthimin e qetësisë, sepse kanë parë shumë herë ndodhë dhe raste të tilla, të cilat mund t'i "përkthejnë" dhe të propozojnë mënyra sjelljeje që ndihmojnë zgjidhjen e situatës. Merren akorde mes kopshtit dhe familjes për mënyrën e qëndrimit përball disa lloj sjelljesh, për të dhënë të njëjtin mesazh dhe jo mesazhe të kundërta. Në ndonjë rast, një krizë e vogël mund të arrijë edhe papritur, atëherë kur duket se gjithçka po shkon mirë. Nuk është i çuditshëm motivi, që fëmijës i mbaron ngarkesa e kuriozitetit dhe e entuziazmit që ka pasur në ditët e para, dëshirën "për të qenë i rritur", që e bënte të guximshëm; por papritmas kupton se gjërat që duhen përballuar janë shumë dhe ndjen dëshirën "të jetë i vogël". Janë ndjenja të njohura që gjejnë mirëkuptim e krahë mikpritës, kështu në pak kohë gjithçka hyn në normalitetin e kopshtit, i cili kthehet në "kopshti im".

**Fillimi i  
kopshtit është  
një ndryshim  
"i fortë" për  
gjithë familjen**

Hyrja në kopsht është edhe momenti kur prindërit u besojnë një pjesë të edukimit dhe të rritjes së fëmijës së tyre, të rriturve të tjerë me të cilët ai do kalojë pjesën më të madhe të ditës. Pra fillon një fasë delikate, në të cilën edukatorët janë përkrah prindërve për të njohur fëmijën deri në fund dhe për ta ndihmuar gjatë ndarjes prej e tyre duke mbajtur në vetvete imazhin e të dashurve dhe garancinë e kthimit tek ata, pasi kanë kaluar një pjesë të kohës me figura të tjera. Për kopshtin, do vit, është vit i ri, sepse të gjithë fëmijët janë të veçantë në unicitetin e tyre dhe në atë të familjeve, janë të ndryshme edhe dinamikat e grupeve që formohen dhe lojërave të krijuara me të cilat luajnë.



*Kopshti im është e bukur brenda dhe jashtë*

*Ludovica*







## **...ku dita kalon ndryshe nga ajo në shtëpi e përbërë nga momente të ndryshme e të panjohura**

### **fëmija njih kopshtin gradualisht**

Në ditët e para qëndrimi i fëmijës në kopsht duhet të jetë graduale në mënyrë që ai të arrijë të njohë e mbizotërojë momentet e ndryshme që kalon aty. Edhe lojrat e propozuara janë fillimisht të thjeshta e kanë rendësinë dhe vlerën e afrimit dhe të njohjes mes fëmijëve dhe të rriturve. Në këtë fazë, kujdesi i edukatorëve drejtohet kryesisht në të mësuarit e "qëndrimit" dhe jo të të "bërit", për motive edukative dhe të krijimit të një bashkësie apo grupi ku fëmijët jetojnë të qetë dhe sillen korrektësisht brenda rregullave kryesore që janë pjesë përbërëse e jetës në kopsht.

### **Me të arritur ndihmohen të rehatohen**

Sapo arrijnë në kopsht fëmijët ndërrojnë këpucët dhe mbathin këpucë më të rehatshme që i përdorin çdo ditë, por që i heqin disa herë, për shembull: për të hyrë në një vend me qilim dhe jastëk ose për të dalë jashtë në oborr. Disa kopshte këshillojnë pantofla prej lecke, kopshte të tjera preferojnë çorape që nuk rrëshqasin, ndërsa në pjesën më të madhe të rasteve u lihet prindërve të vendosin tipin e çorapeve apo pandoflave që duan t'u japin fëmijëve në përdorim, duke mos harruar që duhet të jenë sa më praktike e komode. Një faktor tjetër i rëndësishëm që duhet të mbajnë parasysh është edhe ti japin mundësi fëmijës të jetë i pavarur dhe autonom në përdorimin e këtyre "këpucëve", prandaj është mirë që të jenë të rehatëshme në mbathje dhe lidhje.

**me nje  
veshje të  
përshtatshme  
për të lëvizur  
dhe për të  
luajtur**

Disa realitete kërkojnë përparëse kopshti, të tjerat përdorin përparëse pune vetëm për disa aktivitete, si piktura dhe kërkojnë që gjatë ditës fëmijët të jenë të veshur komod për të luajtur, që rrobat të mos i pengojnë në lëvizje dhe të mos u krijojnë shqetësime nëse bëhen pis. Në fakt është shumë e lehtë që peneli të bëj pis shokun afër, ose pak plastelinë ti ngjitet në gjunjë... d.m.th, është e rëndësishme për fëmijët, ashtu si për të rriturit, që të vishen në mënyrë të përshtatshme për punë, të ndjehen komod dhe autonom, prandaj është mirë që përparësja të ketë një lidhëse të përdorshme lehtësisht, pa u sforcuar, veshjet të mos bëjnë të djersish, të mos kenë zinxhirë mbyllës dhe kopsa të forta; aq më mirë nëse evitohen rrobat me rripa o aksesori të tjera të bukur, por të vështirë në përdorim.

**pastaj fillon një  
ditë me lojëra e  
aktivitete**

Në momentin e hyrjes, fëmijët hyjnë nga një hapësirë ku janë vendosur lodrat, e cila u jep mundësinë e aktivizimit e të takimit. Fëmija mund të zgjedhë, sipas interesave e raporteve, cilën lojë të bëjë dhe me cilët shokë, mund të fshihet në qoshet më të "fshhehta" (por të kontrolluara nga të rriturit), të bëjë i qetë një vizatim o një lojë në tavolinë ose të merret me një ndërtim me lodra konstruktive bashkë me shokë të tjerë. Hapësira e kufizuar dhe e organizuar ndihmon fëmijën të rrijë brenda lojës, të organizohet, të përqendrohet e të shoqërohet me shokët duke i respektuar ato.

**për të  
eksploruar,  
eksperimentuar,  
zbuluar e për  
t'u shprehur  
brenda një  
hapësire të  
posaçme**

Numri i madh dhe shumëllojshmëria e sendeve që janë vënë në hapësirën e lojërave të ftojnë të eksplorosh mundësi të ndryshme dhe të japin ide për krijimtari, ndihmojnë logjikën dhe të shprehurit. Ambienti i kopshtit i jep fëmijës sigurinë e qartësinë në të cilën secili mëson shumë shpejt cili është grupi i tij i referimit në ardhje dhe nisje.

Dalëngadalë fëmijës i jepet mundësia dhe të angazhohet në transformimin e hapësirës e të rregullave, p.sh duke ndërtuar një pistë për makina, një zonë për kafshët plastike, sinjale për të luajtur më mirë... Bashkëpunimi në përcaktimin e zonave dhe lojërave i jep mundësinë fëmijës të ndjehet konkurrues në këtë realitet, ku çdo ditë e më shumë do të jetë pjesëmarrës.

**ku  
memorizohen  
gjerat që bëhen**

Është e rëndësishme për fëmijët që të ngelet shenjë e asaj që është bërë, çfarë ka ndryshuar dhe pse. Kartonë (postera), dosje, broshura, cd; formojnë dokumentacionin, i cili jep mundësinë e përshkimit të rrugës që është ndjekur, për ta parë atë edhe në tjera këndvështrime, duke ditur rrugën e bërë dhe aftësitë e fituara.



*Un shkoj në kopsht me autobus e çdo ditë bëj  
dy udhëtime të bukura.*

*Antonio*





## **...bëhet pjesë në një organizatë të madhe në të cilën komunikohet e bashkëpunohet**

### **Ndjenja e anëtarësisë ndërtohet ditë për ditë**

Shume shpejt fëmija gjen siguri në normalitetin e përditshëm, i përbërë nga momente që mund ti pasqyrojmë; në ngrënien e mëngjesit, në biseda, në të shkuarit në banje, në drekë dhe në përgatitjen për t'u kthyer në shtëpi... Pasi arrijnë të gjithë, edukatorë e fëmijë fillojnë bisedën, ndërkohë që kontrollohet kush është dhe kush mungon, lidhet filli i bisedës së përbashkët dhe me kohë krijohet ndjenja e anëtarësisë.

Çdo kopsht ka mënyrat e veta, por kudo momenti i apelit krijon idenë e të qenit bashkë, të anëtarësisë në një grup. "Jemi të gjithë" nuk është vetëm një nevojë konstatimi por njohjeje si bashkësi. Në fakt dhe ai që nuk është bëhet prezent nga interesimi që demonstron për mungesën e tij.

### **fillohet duke njohur dhe historinë e nevojat e çdo fëmije**

Njohja e historisë së djalit apo të vajzës, problemet që mund të ketë përjetuar, nevojat e tyre të veçanta, lejon thellimin e raportit mes edukatorit dhe atij/asaj, dhe gjetjen e mënyrave për ta ndihmuar. Nëse fëmija ka nevojë për kujdes të veçantë është mirë që të flitet menjëherë me edukatorët, të sinjalizohen për nevojat që ka, duke verifikuar së bashku mundësitë e kopshtit për ta ndihmuar në rritjen e mirëqenies.

Ka edhe ditë e momente që ndonjëri ndjen nevojën për kujdes të veçantë, janë këto situata kalimtare, por që kërkojnë diçka më tepër.

Dialogu mes prindërve e edukatorëve rregullon masën e gjerave, shpesh dimensionon problemet, zakonisht i zgjidh ato. Fëmija "ndjen" fillimisht akordin mes të rriturve që kujdesen për të, respekti i ndërsjellët i krijon atij një rreth mbrojtës.

**Ka rregulla që garantojnë sigurinë e të gjithëve; për dorëzimin e fëmijës**

Kopshti u jep prindërve modulën për të shënuar personin që do të marrë fëmijën nëse nuk mund të vij prindi ta marrë. Është një mënyrë për të garantuar më shumë kontroll, sepse dorëzimi i fëmijës duhet të bëhet gjithmonë i sigurt, në duar të personave të autorizuar e të aftë, për siguresën e tij.

**për komunikime urgjente**

Jeni të lutur të njoftoni edukatorët për mungesën e fëmijës, me një telefonatë ose me një komunikim të shkruar nëpërmjet një letre që dërgoni me ndonjërin. Fëmija bën pjesë në një grup që e pret, prandaj shokët dhe të rriturit kanë kënaqësinë të marrin vesh si është e çfarë bën. Ndërsa kur fëmija nuk ndjehet mirë në kopsht, u takon edukatorëve të njoftojnë prindërit, për këtë është e domosdoshme të lihen në kopsht numrat e telefonit në përdorim.

**për aksidente**

Ndonjëherë mund të ndodhë ndonjë aksident i vogël, si rrëzim gjatë një loje në oborr, duke marrë goditje ose duke u gërvishtur në gjunjë. Është një pasojë natyrale e çapkënlleqeve të moshës. Zakonisht mjafton pak ujë i ftohtë, një leukoplast e një puthje, por nëse fakti është më serioz dhe ka dyshime mbi domosdoshmërinë e një kontrolli klinik më të thelluar, edukatorët njoftojnë menjëherë prindërit. Për të aksidentuarit është parashikuar një sigurim, prandaj në rastet e nevojshme edukatorët u dorëzojnë familjarëve një modul të posaçëm.

**për të papriturat  
e prindërve**

Mund të ndodhë që prindërit të kenë nevojë të vijnë të marrin fëmijën para orarit të parashikuar, në këtë rast është mirë të njoftohet kopshti, kështu edukatorët mund t'i evitojnë fillimin e një aktiviteti të gjatë fëmijës, i cili duke ditur që dita e tij do të jetë ndryshe përgatitet qetësisht për të dalë.

**për t'u kuptuar**

Komunikimi midis prindërve e edukatorëve është i një rëndësie themelore, për këtë organizohen mbledhje në të cilat prezantohen projektet edukative dhe aktivitete didaktike. Parashikohen në program edhe takimet individuale në të cilat flitet për një fëmijë në veçanti, për eksperiencën e tij në kopsht, për miqtë dhe lodrat që preferon, për hapat e tij pozitiv gjatë rritjes. Janë këto momente të rëndësishme për të bashkëzgjedhur rrugën edukative, për të kuptuar rregullat dhe aktivitetet që kopshti çon përpara.



*Un me grupin tim zbavitem shumë!*

*Silvia*







## **...në një kohë që ka kuptim të shoqëruar nga siguria e së përditshmes**

### **Arritja dhe nisja janë dy momente shumë të rëndësishme**

Kur mami o babi, gjyshërit o personat e autorizuar dorëzojnë fëmijën në kopsht dhe e marrin në mbarim të orarit, kryejnë një veprim të thjeshtë por të ngarkuar me emocione, sepse fëmija në ato momente "bëhet" i dikujt tjetër dhe hyn në një botë të ndryshme, me rregulla të tjera, me një pikë tjetër referimi afektiv; anasjelltas kur fëmija kthehet të jetën e familjes.

### **ku ndeshemi me emocione të shumta**

Janë ndjenjat që përcaktojnë stabilitetin e raporteve, prandaj gjatë kalimit, derisa nuk bëhet i zakonshëm, është e nevojshme më shumë mbështetje me fjalë që garantojnë kthimin e të afërmeve dhe i japin masë kohës: "pas drekës", "pas gjumit"... Krijohet kështu një lloj zakoni në të cilin frazat bëhen akt angazhimi: edukatori/ja mirëpret fëmijën dhe e përshëndet sipas personalitetit të vet, kjo ndihmon krijimin e një lloj familjariteti e i jep atij/asaj idenë që po e priste dhe që ky është vetëm fillimi i gjerave të tjera në vazhdim, në të njëjtën kohë fëmija pikas besimin që ka prindi për edukatorin/en dhe e përvetëson atë.

### **Zgjedhja e aktivitetit që do të bëhet me çdo fëmijë, është një fillim i mbarë i ditës**

Edukatori që është një vrojtues kujdesëshëm, mund t'u bëhet ndihmë prindërve në shoqërimin e fëmijës drejt gjërave me interes, por është mbi të gjitha mirëkuptimi i të rriturve që ndihmon në forcimin e sigurisë tek fëmija, që dalëngadalë nis t'i bëjë vend vetes, të zotëroj lojëra e të ketë shokë. Pas pak ditësh fëmijët presin njeri tjetrin, takimet e tyre bëhen gjëja më e rëndësishme.

**që pastaj kalon në situata të njohura**

E përditshmja normale në kopsht është një domosdoshmëri organizative, por jo vetëm kaq, në fakt janë fazat që përcaktojnë ditën dhe ndihmojnë fëmijën ta zotërojë atë edhe nga ana mendore. Janë këto situata të kalimit nga një moment në tjetrin, në të cilat shfaqen aktet e njohura, të cilat u japin siguri. Bashkohen nëpër stola sepse është ora për të shkuar në banjë të lajnë duart, të përgatiten për drekë ose të shkojnë në oborr; rregullojnë vendin pasi kanë kryer mëngjesin ose ndonjë aktivitet tjetër të grupit... Kështu dita "parashikohet", prandaj fëmija e di se çfarë vjen përpara dhe çfarë vjen pas, si fillon një momentet e ditës dhe si mbyllet ai. Kështu ndërtohet nocioni i kohës dhe "kuadri" brenda të cilit rrihet dhe vepron në mënyrë gjithnjë e më aktive.

**Ti bësh gjërat vetëm apo ti bëjmë së bashku; është jeta e kopshtit**

Në kopsht fëmijët ndihmohen të bëhen gradualisht gjithnjë e më të pavarur, për t'u rritur në vetëvlerësim e me kënaqësinë kur i bëjnë vetë gjërat. Kryejnë detyra të vogla të ngarkuara, si të lajnë penelat ose të shtrojnë tavolinën. Sigurisht, kush ka nevojë shoqërohet e ndihmohet nga edukatori o kujdestari që përfaqëson një dashamirës mjaft të fortë, por gjithmonë ftohen të provojnë, nganjëherë edhe me mbështetjen e ndonjë shoku më ekspert.

**e përbërë nga momente të përbashkëta**

Janë edhe momentet e përbashkëta, për shembull: në kohën e përgatitjes për gjumë ose për të ngrënë drekë, pastaj në grupe të vogla kur kryhen veprime që ndihmojnë për të fituar zakone pozitive të përditshme, edhe në brendësi të rrethit familjar: si sistemimi i gjërave, larja e duarve, e dhëmbëve, shkuarja në banjë. Këto veprime të thjeshta bëhen pjesë e kapacitetit për të pasur kujdes për veten e respekt për të tjerët. Ndërsa secili pret turnin e vet, propozohet një lojë e shkurtër dhe mësohen të kenë pak durim.

**prandaj është  
natyrale që  
nganjëherë ka  
edhe momente  
pasigurie**

"Lënia" dhe "gjetja" e familjes janë momente që nganjëherë mund të rezultojnë më shumë të mundimshme sepse shfaqet pak pasiguri, megjithëse periudha e parë e ambientimit ka kaluar. Mund të jetë edhe dita e "papëlqyeshme" siç u ndodh edhe të rriturve, në të cilën duket sikur çdo gjë shkon keq... ose dita e "tekave", që mund të jetë një mënyrë për të kërkuar me tepër kujdes ose demonstrim nervozizmi. Për të gjitha këto, shpesh mjaftojnë disa veprime të vogla të prindërve për t'i qetësuar; të qëndruarit pak më shumë me fëmijën, hyrja në seksion bashkë me të, demonstrimi i asaj çfarë ka ndërtuar, t'i lejojsh të të prezantojë përpara miqve të tij, t'i lësh një send të shtëpisë ta mbajë në xhep....



*Kur bëj një kullë të lartë, të lartë,  
nuk dua ta prish menjëherë!*

*Corrado*





## **...ku fëmijët mësojnë duke luajtur seriozisht dhe duke u argëtuar**

### **në kopsht luhet në shumë mënyra**

Loja është mënyra më autentike e të jetuarit të fëmijës... Përmes lojërash të ndryshme: krijon eksperiencën, ndërton raportet e dashamirësisë, vihet në provë, njih vetveten, njih sendet dhe të tjerët, pra rritet me vetëdije e kapacitet. Në kopshtin e fëmijëve, kryesisht, mësohet duke luajtur; lojëra të ndryshme, krijuese ose me rregulla, në grupe të vegjël ose të mëdhenj, të reja ose të vjetra dhe ato të shpikura me pjesëmarrjen e vetë fëmijëve.

### **duke luajtur arrihet realiteti**

Kështu ndodh që prindërit nganjëherë gjejnë diçka që përsëritet nga koha kur ato ishin të vegjël, që fëmijët e tyre i duan njësoj si ato; herë tjetër shohin lojëra të tjera e të veçanta ndoshta të lindura nga një ide, nga një histori, ose nga eksperiencia që kanë të bëjnë me shkencën e teknologjinë. Shumëllojshmëria e lojërave ndihmon krijimin e eksperiencave të larmishme: nga ato të zhvillimit të logjikës në ato të ndërtimeve praktike, gjithashtu edhe ato të eksperimentimit me materiale të ndryshme që lejojnë zbulimin e aspekteve konjunktive, shqisore, krijuese dhe kapacitetin e veprimtarisë së trupit.

### **të shprehurit mbi vetveten**

është loja "bëj sikur" që luhet të gjitha herët që fëmijët përfaqësojnë realitetin ose fantazinë e tyre nëpërmjet personazheve ose personave të familjes: në një qoshe të shtëpizës personifikojnë rolin e mamit dhe babit, në atë të dyqanit luajnë rolin e shitësit, mbi makinën e ndërtuar me tulla bëhen pilot. Në lojërat teatrale, të maskimeve o të kukullave, fëmijët u japin jetë personazheve që njohin, si "zonja e bukur" ose polici,

gjithashtu edhe atyre imagjinari, duke u dhënë kështu zë mendimeve e dëshirave të tyre. Duke imituar aktivitete të jetës së të rriturve dhe vënë në lojë dhe njohuritë e identitetit të gjinisë mashkullore e femërore. Ndërthurja midis së vërtetës e simulimit, tipike e këtyre lojërave, favorizojnë miqësinë e aleancën midis fëmijëve të së njëjtës moshë dhe me shokët më të "mëdhenj" të njohur si "të zotë".

**bëhen  
arsyetime dhe  
eksperimente  
të ndryshme**

Në lojërat e tipit laboratorik fëmijët manipulojnë e zbulojnë karakteristikat e sendeve, si konsistencën, ekuilibrin, notimin... bëjnë krahasime e kombinime, zgjedhin e kërkojnë zgjidhje, për t'u dhënë formë projekteve të vogla individuale ose të grupit. Materialet e ndryshme që përdorin mund të jenë të pazakonta ose gjëra të përdorura që nxisin eksplorimin në mënyra të ndryshme, duke i hapur rrugë krijimtarisë nëpërmjet kuriozitetit dhe interesit për proceset e transformimit të gjërave.

**ku trupi është i  
pari  
protagonist**

Thuhet që në fazën e parë të fëmijërisë, fëmija "mëson me trup", kjo do të thotë që të mësuarit kalon për eksperiencën trupore para se të kthehet në aftësi arsyetimi abstrakte. Në aktivitetet e manipulimit dhe në lojërat sportive, fëmijët vënë në provë zotësinë fizike e emotive në të cilat argëtimi është pasqyra e një angazhimi mjaft serioz. Duart zhdërvillen në veprime gjithnjë e më të kujdesshme, trupi fiton hapësirën e tij në gara me kërcime e kalime pengesash; fëmija kupton aftësitë e veta, por edhe limitet duke koordinuar lëvizjet e tij me ato të të tjerëve.

**lojërat kanë  
organizimin e  
tyre**

Brenda zonave të ndryshme të përgatitura në seksione të veçantë dhe në momente të ndryshme të ditës, fëmijët kanë mundësi të zhvillohen nëpërmjet lodrave, të cilat zgjidhen në mënyrë të pavarur prej tyre, në zonën e lojës të propozuar nga të rriturit. Çdo zonë

loje është organizuar nga disa rregulla të thjeshta të përcaktuar me marrëveshje, si limiti i numrit të pjesëmarrësve në lojë ose sistemimi i lodrave në vendet e caktuara në fund të lojës. Në disa orare e zona, ndiqen lojëra me një temë të caktuar që nxisin stimulim në drejtime të përfshira në projekte. Fëmijët gjinden në grupe të parapërgatitura sipas moshës ose posaçërisht për të çuar përpara një punë me objektiv didaktik që mësuesit kanë fiksuar dhe e verifikojnë, për të bërë pastaj propozime të reja, duke mbajtur gjithmonë parasysh nevojat e fëmijëve, për një zhvillim harmonik, duke mbajtur në konsideratë edhe interesat që ata paraqesin.

**janë pjesë e planifikimit të projektuar drejt së ardhmes**

Ndër aktivitetet e sistemit parashkollor (kopshtit), gjinden edhe ato të vazhdueshmërisë edukative me çerdhen dhe me shkollën fillore, në të cilat fëmijët vihen në kontakt me shokët më të mëdhenj. Janë takime që zhvillohen me ndonjë temë të posaçme, por kanë si synim kryesor të ndihmojnë kalimin sa më natyral nëpërmjet njohjes së ambienteve të reja. Kështu fëmijët arrijnë të parashikojnë rrugën e tyre të rritjes.



*Në vrimën e rërës un punoj shumë.*

*Ivana*







## **...në kuadrin e një projekti edukativ kombinohet dituria dhe argëtimi**

### **Plani edukativ i kopshtit është një "ndërtim"**

Pas çdo planifikimi ka gjithmonë një angazhim e reflektim mbi mënyrat e organizimit të momenteve të ndryshme të ditës, të qëndrimit me fëmijët, të njohjes së tyre dhe propozimit të përvojës. Ta shohim këtë projekt si një "ndërtim", i përbërë nga disa tulla: tullat janë aktivitetet, shtigjet e punës, organizimi i zonave, i kohës, iniciativat... por dhe takimet e programuara me familjet, me institucionet e tjera shkollore. Me një fjalë të gjitha ato që kopshti është, dhe bën.

### **plani vihet në zbatim gjatë gjithë vitit**

Planifikimi duhet të jetë i përsosur, për të evituar gabime të mundshme, por jo "i mbyllur"; dritaret janë të rëndësishme, ato lejojnë këndvështrime të reja, të vihen re shumë gjëra, të shfrytëzohen raste që prezantohen e si rrjedhim të modifikohet veprimtaria. Planifikimi fillon nga pika themelore; analizimi i hapësirave, vëzhgimin e fëmijëve, lidhjet dhe bashkëpunimet që ekzistojnë nga viti i mëparshëm, propozimet nga ndonjë ent territorial, dhe pastaj shtjellohet, duke mbajtur parasysht interesat e fëmijëve. Në fazën e fillimit të vitit shkollor, projektplanit është "orientues", nevojitet të krijohen shenjat e para, pastaj të kalohet në rrugën e zbatimit e cila do të demonstrojë se ky drejtim është i vlefshëm apo jo. Ndërhyrjet e "mirëmbajtjes" janë momentet e verifikimit të cilat lejojnë modifikimin, shtesa të tjera, rikonfirmim dhe rrugën për të vazhduar më tej.

### **Përfshin shumë persona të**

Organizimi i kopshtit, në fakt, nuk është territor vetëm për figura të veçanta, por një

**brendshëm dhe të jashtëm**

vend i bashkëndarë mes të gjithë atyre që kontribuojnë, secili sipas rolit dhe funksionit të vet. Me një fjalë përfshin edukatorët dhe personelin ndihmës, disa momente të ditës mbarështohen së bashku; si hyrja dhe dalja e fëmijëve, kujdesi higjienik, të ushqyerit. Edhe pastrimi i ambientit, veprimet e përditshme që kualifikojnë kopshtin dhe mënyrën e tij të prezantimit, bëjnë pjesë në planifikimin e përgjithshëm të tij. Situatat e ndryshme të ditës parashtrojnë objektiva të ndryshme dhe kanë nevojë për prezencë të organizuar, që mund të përbëhet nga një ose dy edukatori/e, ose edhe një personel tjetër ndihmës.

**Edhe prindërit bëjnë pjesë në planifikim**

Ndodh në shumë kopshte që ngjashmëria e pikëpamjeve të prodhojë rezultate të mëdha, kështu shohim edhe prindërit të bashkëpunojnë në mënyrë pozitive, të cilët shtojnë emocione e përvojë. Lindin "grupe teatrale" në të cilët nuk duhet të jesh aktor, por duhet të kesh dëshirë të angazhohesh vetëm për t'u dhënë kënaqësi fëmijëve, "grupe ndërtimi", me kompetenca rrobaqepëse o marangoz për të përgatitur kostume për maskime ose skena, gjëra të tjera për të luajtur... Janë të çmuara ndërhyrjet që u paraqesin fëmijëve pjesë nga realiteti, si bëhet buka ose si shartohet një pemë. Grupe muzikantësh e piktorësh arrijnë të vënë në skenë komedi në të cilat nuk dihet se kush argëtohet më shumë, se vetë ato apo fëmijët e tyre që bëjnë spektator dhe duke parë mamin e babin "në veprim" në shkollën e tyre, provojnë kënaqësi të pabesueshme.

**Shkolla është një rrjet relacionesh, të brendshme dhe të jashtme**

Brenda kopshtit thuren marrëdhënie të shumëfishta mes të rriturve dhe fëmijëve, aftësitë e të cilëve bëhen të njohura që në vitet e para të jetesës së përbashkët. Prandaj detyra e edukatorëve nuk është të

japin dije të parazgjedhura por të sigurojë situata që stimulojnë kuriozitetin, frymën e kërkimit dhe nxitjen e zhvillimit të kompetencave të secilit.

Marrëdhëniet me jashtë u përkasin së pari prindërve, në shkëmbimet e rregullta dhe në situata të veçanta, por duhet më pas të përfshijnë edhe edukatorët e çerdhes dhe të shkollës fillore, operatorët e shërbimeve të specializuara dhe të shërbimit social, për të përballuar më mirë nevoja të caktuara të zhvillimit të fëmijëve, të agjencive dhe të institucioneve lokale: muzeumet, bibliotekat... Nga ky rrjet kontaktesh lindin projekte të ndryshme "të shkruar" nga disa duar, jashtëzakonisht stimulues dhe njësues. Kjo jep idenë e një kopshti të hapur përball shoqërisë, komunitetit.



*Un bëj vizatime krijuese sepse kam imagjinatë.*

*Rinaldo*





## ...menaxhohet nga njerëz kompetent e ndjesihollë profesionistë dashamirës

### **Personeli i kopshti: profesionistë Ndjesihollë (empatikë)\***

Empatia\* është aftësia për të ndjerë emocionet e të tjerëve dhe bashkëndarë ato duke u bërë mbështetje.

Edukatorët krijojnë me fëmijët lidhjet të përbërë nga të kuptuarit dhe afërsia që pastaj prodhojnë ato fraza absolute klasike "e ka thënë mësuesi" që tregojnë besim dhe dashuri për atë, me të cilin bashkëjetohet.

Udhëzimet edukative flasin për profesionalizëm të edukatorëve, i cili qëndron në " të dish dhe të jesh në gjendje për të mirëpritur dhe mbështetur fëmijët bashkë me familjet e tyre gjithashtu të jesh në gjendje të përmbushësh nevojat e tyre për njohuri."

### **me kompetenca të azhurnuara vazhdimisht**

Aftësitë e edukatorëve dhe empatia\* e tyre janë elemente thelbësore për cilësinë e kopshtit.

Trajnime të vazhdueshme na lejon për të zhvilluar profesionalizmin që hap rrugët e kërkimeve, azhurnimit dhe thellimit të tematikave.

Është një mjet për të njohur dhe forcuar njohuritë dhe për ti bërë ato aktuale, madje edhe në lidhje me ndryshimet në sistemin e marrëdhënieve shoqërore dhe hulumtimeve fushën e arsimit.

Është një mundësi për të reflektuar në punën e tyre, për të shqyrtuar dhe të eksperimentuar strategji të reja të mësimdhënies dhe për të verifikuar rezultatet e proceseve të vëna në jetë.

Është një "strategji e ripërtëritjes", dhe rritjen së profesionalizmit që duhet të jetë vazhdimisht në hap me kohën.

**në një  
program të  
zgjeruar  
trajnimi**

Trajnimi i stafit mësimor është i menaxhuar në nivelin provincial nëpërmjet strukturave përkatëse. Për vënien në zbatim janë përfshirë të gjithë edukatorët që punojnë në këtë territor, me një programim të hollësishëm dhe verifikim që lejon t'u përgjigjen nevojave të ndryshme dhe të veçanta të disa kopshteve ose një Qendre koordinimi, duke bashkëndarë horizontin e të njëjtit nivel.

**të shumë  
llojeve**

Programet e trajnimit janë të shumëllojshëm: kurse, laboratorë, seminare, ditë studimi ...Secili prej tyre ka qëllime dhe ndarje të veçantë, por së bashku përbëjnë mozaikun në të cilën kalon promovimi i kulturës që përhapet në sociale dhe nxit dialogun me partnerët e saj, para së gjithash me familjen.

**I gjithë  
personeli i  
kopshtit ka një  
profesion  
specifik**

Edhe figurat profesionale të kuzhinës e ato ndihmëse që punojnë në kopsht janë të azhurnuar mbi aspektet shëndetësore që duhet të vëzhgojnë, mbi metodat e magazinimit dhe gatimit të ushqimeve dhe mbi faktorë e tjerë që lidhen me pastërtinë dhe funksionimin e kopshtit. Kopshti është gjithashtu një familje e madhe, në të cilën aftësitë profesionale shoqërohen me interesa për të personalizuar marrëdhëniet me fëmijët. Kjo u jep jetë frazave që shprehin vëmendje ndaj fëmijës dhe mirëpritje, si; "Ciao Mark, gëzohem që je shëruar", "Elisa, të ka parë që vije me biçikletë..."

**di të ndërtojë  
marrëdhënie  
të afërta,  
emocionale  
dhe  
bashkëpunimi**

Bota e relacioneve të fëmijës rritet dhe bëhet e rëndësishme; ato çfarë thotë kuzhinieri, ato çfarë thotë shoferi i autobusit, komplimentet e personelit ndihmës. Këta janë personat që ndihmojnë dhe ngushëllojnë, që u kujtojnë se duhet marrë fleta me komunikimin për prindërit, që njohin shijet e karakteret, nganjëherë edhe ndonjë sekret. Janë prezent në ditëlindje, festa, shëtitje dhe shpesh kanë kontakt të drejtpërdrejt me plakun e vitit të ri...

**Me kopshtin,  
prindi mban  
hapur një  
dialog të  
vazhdueshëm**

Me prindërit bëhen takime të përgjithshme, seksioni, në grupe të vegjël për momente të rezervuara përshkrimit të aktiviteteve që bëhen, në çfarë mënyre dhe me çfarë instrumentesh...

Zgjedhjet arsimore janë sfond për të "afruar" tema arsimore më të zgjeruara, në lidhje me evolucionin dhe rritjen e fëmijëve.

Në takimet individuale, gjinden atëherë hapësira në të cilat ballafaqohen drejtpërdrejt edukatorët dhe prindërit, në një kuadër marrëdhëniesh më të individualizuara, ku vëmendja i kushtohet çdo fëmije në veçanti, përparimit të tij, por edhe të rriturit, vështirësive që ndesh, pyetjeve që gradualisht mund t'i lindin.



*Edukatorja ime është e dashamirëse  
humb durimin vetëm pak.*

*Giovanna*







## **...që e njohin momentet më të "brishta" të vetperceptimit i mëdha apo i vogël**

**Për t'u ndjerë mirë si në shtëpi, kushtohet shumë kujdes, që rritet akoma në raste veçanta**

Ka disa momente që ngjajnë veçanërisht "Familjare", sidomos orari i të ngrënit dhe ai i shkuarjes në krevat, prandaj këtyre momenteve u kushtohet vëmendje e veçantë. Nga pikëpamja e të ushqyerit, tabelat e dietës të furnizuara nga qendra shëndetësore provinciale, janë pikë referimi: pjatancat janë të kombinuara dhe alternohen sipas kriterëve të hollësishme, që kanë hartuar dietologët. Por dihet se pjesa emocionale i duhet shtuar asaj materiale, prandaj vendi i ngrënies përgatitet me shumë kujdes duke e kthyer në një ambient të këndshëm dhe mikpritës, në të cilin janë të pranishëm, përveç edukatorëve, personelit ndihmës dhe, nganjëherë edhe vetë kuzhinieri /ja. Me kalimin e kohës secili mund të ndërtojë marrëdhënie "një me një" kështuqë, edhe pse brenda rregullave të përbashkëta, çdo fëmijë përcepton që edhe ai është kuptuar.

**Si në kohën e drekës**

Mënyra e prezantimit të ushqimit nganjëherë ndihmon të kapërcehen disa "pengesa" dhe favorizon pranimin e ushqimeve që fillimisht refuzoheshin. Duke pasur mundësi eksperimentimi me forma autonome - ndër të cilat vetëshërbimi ose supozimi i roleve, si ai i "kamerierit" ose t'u bëhen ndihmë të tjerëve - fëmijët jetojnë të motivuar, kështu edhe provojnë të shijojnë ushqime që ndoshta në shtëpi u dukeshin të neveritshëm.

**Prindërit Informohen gjithmonë**

Menyja shfaqet në tabelën e njoftimeve të shkollës, kështu prindi është i informuar dhe mund të vendosi në lidhje me vaktin e darkës. Menyja hartohet javore, nganjëherë

edhe për tërë muajin duke u referuar periudhave të vitit, me preferencë frutat dhe perimet e stinës. Familja informohet në lidhje me ushqimin që shërbehet, sipas mënyrës së veçantë të miratuar nga çdo kopsht, e cila garanton njohjen e menysë së ofruar. Në takimet individuale, prindërit mund të informohen edhe më tej për raportin që fëmija i tij ka me vaktin e ngrënies dhe me ushqimin.

**edhe kopshti  
vihet në dijeni  
për problemet e  
të ushqyerit**

Nëse fëmija vuan nga ndonjë alergji është e mjaftueshme paraqitja e certifikatës mjekësore në kopsht për të ndryshuar mënyrën. Ndërsa kur refuzimi i një lloj ushqimi varet vetëm nga rezistenca e fëmijës ndaj tij ka të ngjarë të tejkalohet me kalimin e kohës. Në fakt, qëndrimi në grup, favorizon, sjellje rivaliteti, gjithashtu stafi ka strategjira të ndryshme, jo forcuese, për të ndihmuar fëmijën të provojë shije të reja.

Në rastet më të ndërlikuara duhet të merren akorde direkte me edukatorët, sepse është e rëndësishme që kopshti dhe familja të kenë të njëjtat rregulla. Është pjesë e rritjes së fëmijës edhe të përballuarit gradualisht të së panjohurës, është e lehtë që duke filluar nga një fletë sallate mund të arrijë të hajë një pjatë të tërë.

**Momenti i  
gjumit është një  
tjetër situatë  
delikate**

Kur fëmija është i lodhur, i duket se ndjehet më i vogël. Prandaj ka nevojë për siguri për pak përkëdhelje dhe për ndonjë gjë me shijen e shtëpisë. Në kopshtit ku ka dhomë në dispozicion për të fjetur, fëmijët që e përdorin atë përgatiten në grup me një të rritur që i dërgon në banjë dhe pastaj i ndihmon të bien në gjumë duke bërë aktivitete të përditshme që i qetësojnë. Çdo fëmijë ka një mënyrë e veten të përjetojë këto momente, shumë prej tyre zgjedhin një lodër për ta mbajtur pranë, për ta prekur, për ta mbështur në fytyrën e tij.

Lodra është një lidhje emocionale që e liron nga frika e ndarjes. Mbikëqyrja është e siguruar, duke përfshirë edhe bashkëpunimin e personelit ndihmës.

**ku njihen  
nevojat e  
veçanta të  
secilit**

Dalë nga dalë njihen edhe nuancat e vogla të sjelljeve të fëmijëve për të cilët të rritur e dinë nëse duhet të qasen apo të qëndrojnë larg duke shprehur shënja dashamirësie të njëjta për të gjithë, në një atmosferë të kthjellët për të gjithë. Edhe momenti i zgjimit bëhet i ëmbël duke i dhënë kohë fëmijës për të rimarrë qetësisht veten dhe kontaktin me realitetin. Në kopshte ku nuk ka vend të veçantë për të fjetur ndodhen shtretër të përgatitur o jastëk, në një "zonë e mbrojtur", ose ju ofrohet aktivitet relaksimi që largon lodhjen. Dëgjohet muzikë, rrihet shtrirë dhe "përgjumur" për pak kohë sa për të marrin energji.



*Kur zgjohem shkoj tek miqtë e mi  
të cilët tashmë ishin zgjuar më shpejt.*

*Paul*





## **...si mund të qëndrohet në shkollë në kohë më të zgjatur për një kohë të zgjatur që është e veçantë**

### **Orari i kopshtit është shtatë orë në ditë.**

Kopshti i fëmijëve ka një orar prej shtatë orësh në ditë, orari i fillimi dhe i mbarimit vendosen çdo vit nga Komiteti Drejtues i kopshtit duke marrë parasysh nevojat e familjeve. Disa formula orari janë: për shembull: hapja dhe mbyllja në 8-15, ose 8,30-15,30, ose 9-16

### **por mund të rrijë hapur deri në dhjet orë**

Koha e zgjatur në kopshtin e fëmijëve ka lindur si një përgjigje e nevojave sociale dhe pune e familjeve, duke bërë që koha e zgjatur të arrij deri në 10 orë në ditë. Flasin për kohë të zgjatur si për dy orët para orarit të mëngjesit ashtu edhe për orët e pasdites: shtyrjen e orarit.

### **sipas kërkesave të paraqitura nga familjet**

Çdo vit shkollor Qeveria provinciale përcakton konkursin për peshën ekonomike që u ngarkohet familjeve dhe numrin minimal të fëmijëve për të aktivizuar kohën me orët e zgjatura në çdo kopsht fëmijësh. Për realizimin e kohës me orë të zgjatura sipas regjistrimeve të bëra, çdo kopsht organizon orarin e tij të ditës. Personeli i ngarkuar për kohën e zgjatur, caktohet nga "Programin vjetor i sistemit parashkollor" i përgatitur nga Krahina Autonome e Trentos në bazë të orarit të punës dhe të numrit të fëmijëve të regjistruar në fashat ndryshme të orareve.

### **Janë orë të një kohe të veçantë**

Kjo kohë është e ndryshme nga dita normale e edukimit, por sigurisht me vlerë të barabartë në aspektin edukativ. Për shumë fëmijë prezanton një moment të hapjes dhe të mbylljes së ditës, dhe si e tillë sjell me vete

dinamikat e lidhura me ndarjen nga figurat e familjes dhe të ribashkimit me to pas disa orësh.

**në të cilën fëmijët kanë nevoja të ndryshme në krahasim me momentet e tjera**

Në mëngjes, kush vjen i pari në kopsht gjen një mjedis akoma "pa lëvizje", të qetë, ku nuk kanë filluar lojrat, me pak miq të pranishëm, por së shpejti do të hyjnë të gjithë fëmijët, të cilët do të bashkohen me të parët. Ndërsa në pasditen e vonë, fëmijët që mbeten me kohë të zgjatur ngadalësojnë ritmin dhe zhvillojnë aktivitete të projektuara posaçërisht për kohën e mbylljes së ditës në kopsht; gjithashtu kanë mundësi të kenë marrëdhënie më afërta me të rriturit.

**Aktivitetet janë menduar në mënyrë të përshtatshme**

Formohen grupe të reja dhe ndonjëherë frakuentohen hapësira të reja që bëhen vende që ju përkasin, në të cilat lëmë dhe gjejnë gjurmët e asaj që kanë bërë dhe ndonjë lojë të ndryshme. Në propozimet e aktiviteteve merr më shumë rëndësi që ngrohtësia dhe përmbajtja në "punë" të plotësojë nevojat e fëmijëve gjatë aktiviteteve të këndshme dhe të larmishme.

**shpesh i lidhur me ato të mëngjesit, por pa detyrim**

U dedikohet kohë bisedave, tregimeve të përvojave të bëra gjatë ditës, sepse është një mënyrë e rëndësishme edhe për të konsoliduar njohuritë e përballuara tashmë nga fëmijët dhe për t'i dhënë kuptimin e një vazhdimësie, por pa ankthin e një vazhdimësie të detyruar. Në fakt, nuk mësohet nga grumbullimi i përvojave, por nëpërmjet mundësive që ju lejojnë të riorganizojnë njohurit personale.

**ose të ndryshme, për të pasur një projekt "Vetëm për ne"**

Të bësh gjëra të ndryshme nuk do të thotë të humbësh marrëdhëniet me momentet e tjera të ditës, sepse vazhdimësia është dhënë kryesisht nga stili edukativ i kopshtit, nga qëndrimet dhe lloji i kërkesave ndaj fëmijëve.

Dita është ndarë në kohë të ndryshme, të cilat kanë një domethënie të veçantë dhe për këtë arsye edhe aktivitetet e tyre mund të fillojë dhe të përfundojë me motivim të caktuar sipas llojit të aktivitetit: një histori, një eksperimentim me materiale, një projekt tematike...

**Sa bukur t'u prezantohesh të tjerëve**

Është gjithashtu një kënaqësi e madhe t'u tregosh diçka shokëve të tu të mëngjesit, t'u tregosh atyre një lojë ose një këngë të re, t'u thuash një përrallë që është shkruar në një libër të ilustruar... Si në një familje, në të cilën vijmë, shkojmë dhe tregojmë; edhe në shkollë një fije lidh dhe bashkon gjërat dhe të bën të ndihesh pjesë e të njëjtit komunitet.



Kur nuk jemi shumë, pres më pak dhe  
lëkundem më shumë!

*Martina*







## **...të gjitha këto dhe shumë më tepër brenda organizimit të përgjithshëm për kopshtet e fëmijëve në Provincën e Trentos**

### **Përmbledhje të detyrave dhe qëllimit**

#### **Ligji Krahinor jo 13-21 mars 1977 dhe ndryshimet e mëvonshme**

Ligji 13 e '77, me ndryshimet e bëra më vonë, është ligji që rregullon mbarëvajtjen e kopshtit të fëmijëve në Trentino, i cili paraqet ndër objektivat edukative "zhvillimin e plotë të personalitetit të fëmijës në një edukim të gjithanshëm dhe të së drejtës efektive, të barazisë, të mundësive për arsim, duke tejkaluar pengesat sociale, kulturore dhe mjedisore për t'i siguruar secilit një realizim konkret të të gjitha të drejtave për arsimim dhe arritje të nivelit kulturor bazë duke kapërcyer çdo lloj diskriminimi".

#### **"Udhëzimet mbi aktivitetin e edukimit arsimor të kopshtit të fëmijëve"**

"Udhëzimet mbi aktivitetin e edukimit arsimor të kopshtit të fëmijëve" është një dokument programatik i miratuar me dekret të Presidentit të Bordit Provincial n.5-19/Leg. dd. 15 mars 1995, në të cilin i njihen kopshtit të fëmijëve funksione të rëndësishme edukimi:

#### **prezantohen funksionet e tij edukative**

sigurimi i zhvillimit të potencialit individual: të gjithë djemtë dhe vajzat duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë aftësitë e tyre njohëse, relacionale, emocionale, ekspresive dhe sociale. Dhe është detyrë e kopshtit të evitohet çdo vështirësi dhe të krijojë kushte që kjo të realizohet; të mbështesë dialogun dhe promovojë krahasimin me sistemet e tjera të edukimit, me besime të ndryshme fetare dhe shprehjeve të reja në këtë fushë; të ndihmojë rritjen e përkushtimit dhe të përgjegjësisë, të solidaritetit, të rritjes dhe të zhvillimit të vlerave etike të tilla si solidariteti, bashkëpunimi, ndjenja e përgjegjësisë, e

angazhimit vullnetar, të kuptuarit dhe pranimit të të tjerëve edhe se janë të ndryshëm, të nxisë vlerësimin e dallimeve dhe ndryshimeve të identitetit dhe social-kulturore si një shenjë pluraliteti, vlera të cilat mund të interpretohen dhe jetohet në grupe të ndryshme shoqërore. Ajo mbështet identitetin e grupeve gjuhësore dhe kulturave të ndryshme, të huaja, nëpërmjet rrugëve specifike të përgatitura dhe të strukturuar enkas.

**Mes ligjit dhe udhëzimeve**

Ligji nr.13 dhe udhëzimeve, shtrihet një sistem parashkollor me specifika të veçanta dhe i përfshirë në sistemin shkollor, që nuk shihet si përgatitje për shkollën fillore, ose si një zëvendësim i familjes, por që "ndjek dhe vlerëson plotësisht personalitetin e fëmijës në unitetin dhe integritetin e përgjithshëm të tij, proces i projektuar qëllimisht për të nxitur forcimin e identitetit dhe të autonomisë".

**Shfaqet ideja e fëmijës aktiv dhe të aftë**

Që në moshë të vogël fëmija, të cilit i njihet bagazhi i eksperiencës dhe i emocioneve, konsiderohet në gjendje të lexojë realitetin dhe të japë shpjegime. Eksperiencat e përbashkëta me të rriturit i jep kuptim të jetuarit dhe e ndihmon atë të marrë aftësi personale që favorizojnë pjekurinë e identitetit dhe zhvillimin e këtyre aftësive.

**Bashkëpunimi me familjet**

Detyra edukative përfshin edhe bashkëpunimin me familjen pasi është vendi kryesor i rritjes dhe zhvillimit, sidomos për specifikat e marrëdhënieve të saja. Bashkëpunimi i domosdoshëm midis prindërve dhe të rriturve më të afërt krijon një komunikim të zhdërvjelltë midis mjedisit të kopshtit dhe atij ku jetojnë fëmijët.



## **Organizimi**

### **Hapësira kohë kopsht**

Kopshti është e hapur për jo më pak se 10 muaj në vit, 5 ditë në javë, për maksimumin deri në 10 orë në ditë.

### **Organizimi I brendshëm**

Kopshti është i organizuar në seksione (grupe ose klasa), të cilat zakonisht përmbajnë nga 25 fëmijë, por jo më pak se 15. Gjatë ditës janë parashikuar aktivitete për të angazhuar fëmijët e seksioneve të ndryshme, në grupe sipas moshës ose laboratorit, për lojëra, eksperimente dhe aktivitete shumë të larmishme...

### **Personeli I kopshtit**

Mësuesit janë nga dy për seksion, por në rastet kur kopshti është e hapur për më shumë se 7 orë në ditë është caktuar personel shtesë për orët e nevojshme të ditës, gjatë periudhës së aktivizimit të zgjatjes së orarit. Personeli jo-mësimdhënës, kuzhinier/e dhe stafi i edukatorëve mbështetës, kryen në shkollë detyra të rëndësishme që lidhen me funksionimin e mensës, shërbimin e pastrimit dhe transportit, ndihmon gjatë hyrjes dhe daljes, kujdeset për higjienën personale dhe kolektive, gjithashtu edhe për atë të ambientit dhe të orendive. Ata janë figura me të cilat fëmijët përballen në momente të ndryshme të ditës dhe ndonjëherë marrin pjesë edhe në aktivitetet arsimore me iniciativa të ndryshme.

### **Shërbimi i mensës**

Në kopsht, fëmijët hanë ushqimin e drekës, për këtë Administrata Provinciale, çdo vit, përcakton tarifat e shërbimit të mensës të cilat përballohen nga familja.

### **Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara ose që kanë probleme**

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë të përfshirë dhe të integruar në sistemin parashkollor, në seksionet e të cilëve ka edhe mësues të specializuar si mbështetës për të favorizuar pjesëmarrjen e këtyre fëmijëve në aktivitete ose kurse të individualizuara sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara.

## Organeve përfaqësuese

**Komiteti i menaxhimit (neni 11,12 L.P.n. 13/77) përbëhet**

Në çdo kopsht fëmijësh është ngritur një **Komitet menaxhimi**, i cili përbëhet nga përfaqësues të të gjitha kategorive: - Personeli mësimdhënës - një përfaqësues të personelit jo-mësimor - dy përfaqësues të Komunës, ku ndodhet kopshti - përfaqësuesit e prindërve janë në numër të barabartë me anëtarët e tjerë...



<b>detyrat e tij</b>	Komiteti i menaxhimit përcakton dhe vendosë udhëzimet e aktivitetit edukativ me ndryshimet e nevojshme duke i adaptuar sipas nevojave të komunitetit, për arritjen e objektivave të përgjithshme të vendosura nga Ligji 13; në këtë drejtim bën edhe propozimet për stafin e Bordit. Vigjilon edhe mbi shërbimin e mensës, vendos oraret dhe kalendarin e regjistrimit sipas kërkesave të legjislacionit provincial bën propozimet në fushat e përcaktuara nga ligji.
<b>Kolegji (ose bordi) i personelit (15 Neni L. P. n. 13/77) përbëhet</b>	I gjithë personeli, ai mësimdhënës dhe ai ndihmës, që shërben në një qendër parashkollore përbën stafin e <b>Kolegjit (Bordit)</b> .
<b>detyrat e tij</b>	Detyra e tij është të organizoi aktivitetet e kopshtit dhe stafit, si dhe të mbajë lidhje me prindërit. Ai merret me planifikimin e aktivitetit arsimor dhe merr të gjitha masat e duhura për shkëmbimin e informacionit.
<b>Asambleja e prindërve (neni 16 L.P. n. 13/77) përbëhet</b>	Nënat dhe baballarët e djemve dhe vajzave që ndjekin një qendër parashkollore, krijojnë një organizatë të quajtur <b>Asambleja e prindërve</b> . Kryetari i Asamblesë është një prind, i cili zgjidhet në takimin e parë, qëndron në detyrë për një vit dhe thërret Asamblenë në ambientet e shkollës sa herë e gjykon të arsyeshme.
<b>detyrat e saja</b>	Asambleja e Prindërve i bën propozime Komisionit të Menaxhimit dhe personelit të Bordit, sipas funksioneve përkatëse, duke i dhënë përparësi të veçantë veprimtarisë edukative.
<b>Kolegji (ose bordi) edukatorëve</b>	Mësuesit me kohë të papërcaktuar, dhe të përkohshmit, të tillë për shembull janë personeli zëvendësimit, të gjithë bashkë

**(nenet 59, 60  
L.P. n. 13/77)  
përbëhet nga**

formojnë **Kolegjin (Bordin) i edukatorëve** i cili kryesohet nga Koordinatori pedagogjik.

**detyrat e tij**

Kolegjit (bordit) të edukatorëve i takon të përcaktojë kohën dhe kriteret arsimore dhe të vlerësojë ecurinë e tyre.

Kriteret e përgjithshme për shpërndarjen e orëve të personelit mësimdhënës dhe zhvillimit të aktivitetit në kopsht, duke përfshirë edhe metodat e integritit e parandalimit; të kohëzgjatjes së iniciativave dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera.

Detyra e tij është të bëjë propozime për formimin e seksioneve dhe të zgjedhjes së materialeve, pajisjeve mësimore dhe lodrave. Gjithashtu bën propozime për shërbimet kompetente në fushën e trajnimit të personelit për të përmirësuar iniciativat e edukatorëve të kopshtit; për eksperimentimin metodologjik dhe kërkimor dhe atë të programit mësimor vjetor, të aktiviteteve që nuk janë të lidhura me mësimdhënien por me funksionimin e kopshtit.



## Struktura

<b>Shërbimet</b>	Kompetenca e shërbimit provincial parashkollor u referohet dy fushave shërbimi: <b>Shërbimi parashkollor, ai arsimor dhe i trajnimit profesional</b> , që merret kryesisht me anën programuese, dhe të menaxhimit; <b>Shërbimi për zhvillim dhe rinovimin e sistemit arsimor dhe të aftësisht</b> , e cili merret në mënyrë të veçantë me promovimin e arsimit, trajnimin e edukatorëve, me hulumtimin, inovacionin, eksperimentimin dhe koordinimin e mësimdhënies në përgjithësi.
<b>Personeli drejtues i Shërbimeve</b>	Departamentit të Arsimit Shërbimit për zhvillimin dhe rinovimin e sistemit arsimor dhe trajnimit Drejtori i Përgjithshëm <b>Marco Tomasi</b> Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës për koordinimin pedagogjik <b>Miriam Pintarelli</b> Drejtori i Shërbimit arsimor parashkollor, Menaxher i trajnimit profesional <b>Roberto Ceccato</b> Drejtor i Zyrës për kujdesin ndaj fëmijëve <b>Emanuela Maino</b>
<b>Qendrat e koordinimit</b>	Kopshte e fëmijëve të Provincës janë të grupuara në 12 <b>Qendra bashkërendimi</b> dhe në çdo qendër është vendosur një figurë koordinatori edukativ. Gjithashtu për kopshtet Ladine është krijuar një koordinim edukativ provincial Ladin.
<b>Koordinatori pedagogjik</b>	<b>Koordinatori pedagogjik</b> kryen funksionin e këshilltarit pedagogjike - didaktik në favor të kopshtit dhe mbikëqyr zbatimin e rregullave ligjore dhe marrjen e masave administrative të nevojshme, madje edhe ato të emergjencës, për të siguruar funksionimin dhe sigurinë në klasave të kopshtit.

**Komunat**

**Komunat** ofrojnë ndërtesa me premisa të përshtatshme për kopshtin e fëmijëve, sigurojnë pajisje, orendi dhe lodra si dhe mirëmbajtjen dhe zëvendësimin e tyre. Përdoren fondet e Provincës për punësimin e personelit jo- mësimdhënës, organizimin e shërbimit të mensës dhe funksionimin e kopshtit, duke përfshirë personelin mësimor dhe administrativ.



## I Circoli di coordinamento

- Circolo n. 1** Circolo n. 1 BASELGA DI PINÉ  
Via del 26 Maggio, 8/1 – 38042  
tel. 0461.558849 – fax 0461.553980  
[circolo.coordinamento01@provincia.tn.it](mailto:circolo.coordinamento01@provincia.tn.it)  
Coordinatore pedagogico  
**Giuliana Battisti**  
Scuole dell'infanzia:  
*M. Maddalena Lazzeri-Capriana, Casatta, Daiano, Baselga di Piné, Miola, Rizzolaga, Molina di Fiemme, Piazze-Bedollo, Grumés, Varena.*
- Circolo n. 2** Circolo n. 2 BORGO VALSUGANA  
Via Temanza, 4 – 38051  
tel. 0461.755804 – fax 0461.755805  
[circolo.coordinamento02@provincia.tn.it](mailto:circolo.coordinamento02@provincia.tn.it)  
Coordinatore pedagogico  
**Riccarda Simoni**  
Scuole dell'infanzia:  
*Natale alpino-Agnedo di Villa Agnedo, Bieno, Canal San Bovo, Caoria, Castello Tesino, Imèr, Taita Marcos-Levico Terme, Novaledo, Prade.*
- Circolo n. 3** Circolo n. 3 PERGINE VALSUGANA  
Viale Dante, 5 – 38057  
tel. 0461.501808 – fax 0461.501809  
[circolo.coordinamento03@provincia.tn.it](mailto:circolo.coordinamento03@provincia.tn.it)  
Sostituto Coordinatore pedagogico  
**Alessandra Azzolini**  
Scuole dell'infanzia: Bosentino, Civezzano, Fierozzo, Sant'Agnese, *Il Girotondo-Sant'Orsola*, Seregnano, Tenna, Vattaro, Vigolo Vattaro.
- Circolo n. 4** Circolo n. 4 TRENTO  
Via Gilli, 3 – 38100  
tel. 0461.496954 – fax 0461.496950  
[circolo.coordinamento04@provincia.tn.it](mailto:circolo.coordinamento04@provincia.tn.it)  
Coordinatore pedagogico  
**Patrizia Fellin**

Scuole dell'infanzia: *Mamma Teresa-Cimone*,  
Trento: *Maso Ginocchio-Collodi*, *Torrione*,  
*Il castello-Mattarello*, *Girotondo-Ravina*,  
*Gli gnomi del bosco-Romagnano*, *Piedicastello*.

**Circolo n. 5**

Circolo n. 5 TRENTO  
Via Gilli, 3 – 38100  
tel. 0461.496955 – fax 0461.497257  
[circolo.coordinamento05@provincia.tn.it](mailto:circolo.coordinamento05@provincia.tn.it)  
Coordinatore pedagogico

**Flavia Perini**

Scuole dell'infanzia: Calavino, Lasino,  
Terlago; Trento: *Il Melograno-Cadine*,  
*Piccolo Principe-Cristo Re*, *Sardagna*,  
*Biancaneve-Gardolo*, *Margit Levinson-*  
*Roncafort*, *San Martino*.

**Circolo n. 6**

Circolo n. 6 TRENTO  
Via Gilli, 3 – 38100  
tel. 0461.496956 – fax 0461.496950  
[circolo.coordinamento06@provincia.tn.it](mailto:circolo.coordinamento06@provincia.tn.it)  
Coordinatore pedagogico

**Flavia Ioris**

Scuole dell'infanzia: *L'Albero azzurro-*  
*Cavedago*, *Fai della Paganella*, *Roverè della*  
*Luna*, *Il Germoglio-San Michele all'Adige-*  
*Faedo*, *Il giardino del sole-Grumo*;  
Trento: *Il girasole-Melta*, *Il quadrifoglio-*  
*Solteri*, *Arcobaleno-Martignano*, *Meano*.

**Circolo n. 7**

Circolo n. 7 CLES  
Viale Degasperi, 10 – 38023  
tel. 0463. 625230 – fax 0463.421679  
[circolo.coordinamento07@provincia.tn.it](mailto:circolo.coordinamento07@provincia.tn.it)  
Coordinatore pedagogico

**Laura Bertoldi**

Scuole dell'infanzia: *Castelfondo*, *Ruffrè*, *Cunevo*,  
*Peter Pan-Cavareno*, *Casa del sole-Cles*,  
*Rallo-Tassullo*, *Il nuovo germoglio-Revò*,  
*La città della gioia-Romeno*, *Giardino dei sogni-*  
*Sarnonico*, *f.lli Remondini-Sporminore*,  
*Bosco degli gnomi-Vervò*.

- Circolo n. 8** Circolo n. 8 TIONE  
Edificio 'Il centro' Via Circonvallazione - 38079  
tel. 0465.343312 – fax 0465.343313  
[circolo.coordinamento08@provincia.tn.it](mailto:circolo.coordinamento08@provincia.tn.it)  
Coordinatore pedagogico  
**Giuseppe Pesenti**  
Scuole dell'infanzia: Bezzecca, Cimego, Darzo, Dro, *Filippo Serafini-Preore, Rione 2 Giugno-Riva, Romarzollo, Tiarno di Sopra, Tiarno di Sotto, Zuclo-Bolbeno.*
- Circolo n. 9** Circolo n. 9 ROVERETO  
Complesso 'Intercity' Viale Trento, 37/E – 38068  
tel. 0464.493116 – fax 0464.493117  
[circolo.coordinamento09@provincia.tn.it](mailto:circolo.coordinamento09@provincia.tn.it)  
Coordinatore pedagogico  
**Loredana Michellini**  
Scuole dell'infanzia: Rovereto: Fucine, *Cesare Battisti, Noriglio, Via Livenza, Il giardino incantato-Rione Sud, don Antonio Rossaro-San Giorgio; Isera, Sant'Anna-Vallarsa, Raossi-Vallarsa, Il Girasole - Tierno di Mori, Piazza-Terragnolo.*
- Circolo n. 10** Circolo n. 10 ROVERETO  
Complesso 'Intercity' Viale Trento, 37/E – 38068  
tel. 0464.493114 – fax 0464.493115  
[circolo.coordinamento10@provincia.tn.it](mailto:circolo.coordinamento10@provincia.tn.it)  
Coordinatore pedagogico  
**Paola Barberi**  
Scuole dell'infanzia: Rovereto: Brione, Rione Nord, *Amici della scuola-Sant'Ilario; Besenello, Calliano, Giuseppe Boschetti-Folgaria, Chiesa-Lavarone, Luserna, Nogaredo, Nosellari, don Andrea Rainoldi-Pomarolo.*
- Circolo n. 11** CIRCOLO n. 11 MALÉ  
Via 4 Novembre, 4 – 38027  
tel. 0463.909700 - 909714 – fax 0463.909701  
[circolo.coordinamento11@provincia.tn.it](mailto:circolo.coordinamento11@provincia.tn.it)  
Coordinatore pedagogico  
**Lucia Cova**

Scuole dell'infanzia: Cogolo, Croviana, Mestriago-Commezzadura, *Agostino Ravelli*-Mezzana, Monclassico, Peio, *Antonio Bontempelli*-Pellizzano, Piazzola-Pracorno-Rabbi, *Caterina Greifenberg Rizzi*-Terzolas. Livo-Varollo, Mione-Rumo.

**Circolo n. 12** CIRCOLO n. 12 TRENTO  
Via Gilli, 3 – 38100  
tel. 0461.496952 – fax 0461.497257  
[circolo.coordinamento12@provincia.tn.it](mailto:circolo.coordinamento12@provincia.tn.it)

Coordinatore pedagogico

**Ruth Maria Stankowski**

Scuole dell'infanzia: Trento: *Crosina Sartori*, *G. Rodari*, *L'albero del sole*-Madonna Bianca, *Piccolo Mondo*- Clarina, Povo, *L'officina degli gnomi*-Villazzano 3; *Arcobaleno*-Palù di Giovo, Verla di Giovo, *Girotondo*-Zambana.

**Circolo scuole ladine** COORDINAMENTO PEDAGOGICO  
SCUOLE PROVINCIALI DELL'INFANZIA LADINE  
Strada G. Soraperra, 6 – 38036 Pozza di Fassa  
tel. 0462.760340 – fax 0462.760001  
[coordinamento.scuoleladine@provincia.tn.it](mailto:coordinamento.scuoleladine@provincia.tn.it)

*Sorastant de la scola ladines*

**Mirella Florian**

*Svolge funzioni di coordinamento pedagogico*

**Tatiana Soraperra**

Scuole dell'infanzia: Canazei, Pera di Fassa, Soraga.

## **Shënime mbi kopshtin e fëmijës tim**

### **Emrat dhe numrat në duart tuaja**

Emri shkollës

---

Adresa

---

Numri i telefonit

---

Numri i faksit

---

Numri i fëmijëve të  
regjistruar

---

Numri i seksionit

---

Orari i hapjes

---

Orari i daljes së fëmijëve

---

Koordinatori pedagogjik

---

Numri i telefonit

---

Edukatori i fëmijës tim

---

Personelit ndihmës i kuzhinës  
dhe tjetër personel ndihmës

---

Kryetar i Komitetit të  
Menaxhimit

---

Presidenti i Asamblesë së  
prindërve

---















**F.I.O.R.E.**  
FAMIGLIA, INFANZIA,  
ORIENTAMENTI,  
RIFLESSIONI EDUCATIVE